



NJOFTIM PËR SHTYP

DIZAJNI I RI ITALIAN

**Ilaria Bianchi, Federica Biasi, Matteo Cibic,
Serena Confalonieri, Antonio Facco, Elena Salmistraro, Tipstudio**

8 korrik – 30 gusht 2021

TIRANË, COD - Center For Openness And Dialogue Sala 'Tako Artistin'

Me rastin e **Ditës së V të Dizajnit Italian në Botë - Italian Design Day** -në Tiranë do të ekspozohet brezi i ri i dizajnit italian. Shtatë talente të reja - **Ilaria Bianchi, Federica Biasi, Matteo Cibic, Serena Confalonieri, Antonio Facco, Elena Salmistraro, Tipstudio** - do të ekspozojnë punimet e tyre, nga data 8 korrik deri më 30 gusht 2021, në **Sallën Tako Artistin** të **COD - Center for Openness And Dialogue**.

Ekspozita me titull '**Dizajni i ri italian**' promovohet nga Instituti Italian i Kulturës në Tiranë në bashkëpunim me **IMF Foundation** dhe nën kujdesin e **Elisabetta Pisu**.

Në ekspozitë gjejmë thjeshtësinë formale dhe estetikën minimaliste të **Federica Biasi**; dizajnin utopik të **Matteo Cibic** midis dizajnit, artit dhe artizanatit të lartë; humanizimin e **Antonio Facco** që shkon nga arkitektura e brendshme tek objekti; harmoninë e formave dhe stilin poetik të **Elena Salmistraro**, një përzierje të ilustrimit, dizajnit dhe arteve pamore; eksperimentimin dhe analizën e thelluar mbi materien të dyshes krijuese **Tipstudio**, që shndërron çdo ide në një produkt narrativ dhe simbolik; format arketipe dhe gjuhën shprehëse të **Ilaria Bianchi** drejt një dizajni modeli më kritik dhe konceptual; sipërfaqet grafike të **Serena Confalonieri** që, në kontrast midis formës dhe ngjyrës, nxjerrin në pah lehtësinë e objekteve.

Dizenjues të rafinuar, kuriozë dhe pa dogma, të cilët po i japin jetë një epoke të re të dizajnit italian, ku liria e shprehjes është pozicionuar në qendër të kërkimit, me krijime me një ndikim të fortë ndjellës që kapërcen në art.

Sipas Ambasadorit Italian në Shqipëri Fabrizio Bucci "*ekspozita e sotme paraqet, jo vetëm një përzgjedhje të punëve të shtatë dizenjuesve të rinj bashkëkohorë, për më tepër të njohur dhe të vlerësuar në nivel ndërkombëtar, por gjithashtu na lejon të zbulojmë ngjashmëri, mospërputhje dhe ndikime të dukshme ose të fshehta me tradita të tjera estetike, duke filluar nga Lindja e Largët në Mesdhe si dhe me mënyra të ndryshme për t'iu qasur punës mbi materie "*

Dizajni italian - siç shprehet drejtoresha e Institutit Italian të Kulturës në Tiranë Alessandra Bertini Malgarini: "*lind nga lëvizja movimentista, eksperimental dhe avangardë, i jashtëzakonshëm në thjeshtësinë e tij, por edhe i arritshëm dhe i matur. Këto karakteristika i bëjnë produktet e tij të njihen menjëherë dhe të mbeten të përzetshme.*

Dizajni i ri italian

**Ilaria Bianchi, Federica Biasi, Matteo Cibic,
Serena Confalonieri, Antonio Facco, Elena Salmistraro, Tipstudio**

Për informacione të mëtejshme: www.iictirana.esteri.it